

Në bazë të nenit 19 të Ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës Nr. 2004/7, nenit 27 të Statutit të Odës Ekonomike të Kosovës, Kryetari i OEK shpallë këtë:

FTESË PUBLIKE PËR KAMPANJËN E MARKETINGUT

Oda Ekonomike e Kosovës, bënë ftesë publike për dërgimin e ofertave për kampanjën e marketingut për Panairin Bujqësor dhe të Energjisë së Ripërtëritshme "Agri-Renew 2024", i cili do të mbahet me datë 21-23 tetor 2024, në "Prishtina Mall".

SHËRBIMET E KËRKUARA:

Nr.	Përshkrimi
1	Video promocionale
2	Fotografimi gjatë Panairit dhe konferencave
3	Dizajnimi i portës hyrëse nga konstruksione të aluminit
4	Dizajnimi i hyrjes kryesore në sallën e Panairit
5	Dizajnimi i ceradës brenda Panairit (hapësirë e përafërt 4m x 4m)
6	Dizajnimi i mbishkrimeve dhe ceradave për veshjen e konstruksioneve të aluminit për kompanitë ekspozuese
7	Dizajnimi i broshurave, bexhave (badge), mirënjohjeve
8	Dizajnimi i shfaqjes (cover) për hapjen zyrtare të panairit dhe konferencave në LED screen
9	Video përmbledhëse e Panairit dhe Konferencave

Kompania duhet të ketë përvojë të punës në këtë fushë dhe të siguroj personel profesional dhe të mjaftueshëm për të realizuar me sukses shërbimet e kërkuara.

Oferta zyrtare duhet të përmbajë vulën dhe nënshkrimin e personit të autorizuar të kompanisë, dhe së bashku me certifikatën e biznesit të dërgohen në email: tradefairs@oek-kcc.org, duke shënuar në subjekt mbishkrimin: Ofertë për Ftesën Publike Nr. 249.

Për shkak të kohës së limituar, afati i fundit për aplikim është data 15 tetor 2024, e martë, ora 12:00. Ftesa për ofertim publikohet në uebfaqen zyrtare dhe Facebook-un e Odës Ekonomike të Kosovës.

Kriteri i përzgjedhjes së kompanisë përfituese është çmimi më i volitshëm i ofertuar (çmimi më i ulët).

Lulzim Rafuna
Kryetar
Oda Ekonomike e Kosovës

